



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit nga Siemens Energy AG, nëpërmjet filialit të zotëruar plotësisht, Siemens Gas And Power Holding B.V., mbi Biznesin Grek të Energjisë.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e kryer mes shoqërive Siemens Gas and Power Holding B.V. dhe Siemens A.E Electrotechnical Projects and Products.

Referuar dokumentit “Marrëveshje ndryshuese mbi Marrëveshjen Kuadër”, palët në marrëveshje janë:

Shitësi: Siemens Aktiengesellschaft (Siemens AG), është një shoqëri aksionare e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë, me fushë aktiviteti: Fokusimi në fushat e elektrifikimit, automatizimit dhe dixhitalizimit, të elektronikës dhe inxhinierisë industriale në botë.

Blerësi: Siemens Gas and Power Holding B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: Themelimin, pjesëmarrjen dhe financimin në shoqëri dhe biznese, etj. Shoqëria kontrollohet nga Siemens Energy AG, një shoqëri aksionare e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë.

Siemens Energy Single Member Societe Anonyme (Siemens Energy S.A) është një shoqëri anonime e themeluar sipas legjislacionit grek dhe qëllimi i shoqërisë është: Kërkimi dhe zhvillimi, mekanika, ndërtimi, shitja, shpërndarja dhe shfrytëzimi i produkteve, sistemeve, faciliteteve dhe zgjedhjeve në sektorët e prodhimit të energjisë, të shpërndarjes së energjisë, të depozitimit të energjisë, të nxjerrjes, të shfrytëzimit dhe të përpunimit të naftës dhe të gazit ajror, etj.

Targeti: Biznesi Grek i Energjisë, pjesë e bizneseve të Siemens AG, i cili nëpërmjet marrëveshjes së Spin-Off do të ndahet nga Siemens A.E dhe do të përthithet nga shoqëria Siemens Energy S.A, e cila është themeluar për këtë qëllim.

Shoqëria Siemens A.E. Electrothechnical Projects and Products (GR), nëpërmjet Siemens A.E Electrotechnical Projects and Products – Dega në Shqipëri, realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.